

NJOFTIM

Nga data 20.03.2020 hapen zyrtarisht aplikimet në programin e fondit të ekselencës për vitin 2020, për të gjithë kandidatët.

Dokumentacioni i aplikimit, kriteret dhe procedurat mbi bazën e të cilave do të kryhet përzgjedhja e kandidatëve të cilët aplikojnë për të përfituar mbështetje financiare nga Fondi i Ekselencës, janë të përcaktuara në Vendimin nr. 160, datë 19.02.2020 të Këshillit të Ministrave “Për mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer dhe të nëpunësve civilë (Fondi i Ekselencës)” dhe udhëzimin nr. 6, datë 04.03.2020 të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë “Për përcaktimin e rregullave për afatet e aplikimit, të zbatimit të kriterëve dhe procedurave, për përcaktimin e masës dhe mënyrës së financimit, si dhe numrin e anëtarëve dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve për anëtarë komisioni për dhënien e bursave të parashikuara nga fondi i ekselencës për studentët e shkëlqyer dhe nëpunësit civilë”. Aktet nënligjore të sipërcituar janë publikuar në rubrikën e Fondit të Ekselencës në faqen zyrtare të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Aplikimet kryhen vetëm online në shërbimin e fondit të ekselencës në portalin e-albania.

Pas kryerjes së aplikimit online, dokumentet e specifikuara në udhëzimin nr. 6, datë 04.03.2020, të sipërcituar, për secilën prej kategorive, dërgohen me postë në adresën:

Fondi i Ekselencës
Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë
Rr. Durrësit, nr. 23ALB-1001-TIRANA

**Për çdo informacion të mëtejshëm mund të kontaktoni me e-mail në adresën elektronike:
fondi.ekselenca@arsimi.gov.al**